



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1243

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) FONDERIA E & E SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me nyje per SRS 470 dhe BRS 1200 me numër të prokurimit KEK-25-7550-1-1-1, me 03.02.2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE FONDERIA E & E SH.P.K. me nr. 2025/1243, e datës 19.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me nyje per SRS 470 dhe BRS 1200 me numër të prokurimit KEK-25-7550-1-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me nyje per SRS 470 dhe BRS 1200 me numër të prokurimit KEK-25-7550-1-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik FONDERIA E & E SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.08.2025 KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizim me nyje per SRS 470 dhe BRS 1200 me numër të prokurimit KEK-25-7550-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë hapur, lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 199,470.70 €.

Me 03.12.2025 KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE N.T.SH. ARB - COM.

Me 06.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 09.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.12.2025, OE FONDERIA E & E SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1243, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues FONDERIA E & E SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Neni 40 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Njoftimi për kontratë është bërë me datë 18.08.2025, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 30.09.2025. Ndërsa njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) ishte publikuar me datë 31.10.2025, ku ishte rekomanduar për kontratë OE N.T.SH. “Arb-Com” me çmim prej 182,236.60 €. Ne në këtë aktivitet të prokurimit kemi ofertuar me çmim prej 174,274.20 €.

Neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar, ku ishte shënuar si në vijim. Kundër njoftimit mbi vendimin e lartcekur ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 05.11.2025, ndërsa me datë 07.11.2025 ne kemi pranuar vendimin e AK-së për kërkesën tonë për rishqyrtim, ku e njëjta është aprovuar si pjesërisht e bazuar dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim.

Gjatë rivlerësimit neve na janë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me katalogët e ofruar, ku AK-ja kishte kërkuar si në vijim. Në lidhje me kërkesën për sqarime, ne kemi dhënë përgjigjen tonë, ku i kemi bashkëngjitur të gjitha dokumentet e kërkuara nga ana e AK-së dhe të njëjtat janë në tërësi sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Pasi që i kemi kthyer përgjigje autoritetit kontraktues, ne me datë 03.12.2025 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku përsëri, edhe tani pas rivlerësimit, është rekomanduar për kontratë OE N.T.SH. “Arb-Com”, ndërsa ne përsëri jemi eliminuar, ku tani AK-ja ka shtuar edhe disa arsye të eliminimit të cilat nuk kanë qenë në njoftimin mbi vendimin paraprak.

Tani ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Sa i përket arsyes së parë të AK-së, ku e ka cekur se ne kemi dorëzuar një broshurë të kombinuar vetëm me disa fotografi, pa specifikime teknike dhe pa dokumentacion zyrtar të prodhuesit, ju sqarojmë se e njëjta arsye është e paqëndrueshme dhe e pabazuar, për faktin se ne edhe në kërkesë për rishqyrtim e kemi sqaruar qartë se ne jemi vetë prodhues.

Ne edhe një herë po e sqarojmë se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë si në vijim: “2. Katalogë, pjesë të katalogut apo prezantime grafike (vizatime) ose fotografi të produkteve për furnizim, bashkëngjitur përshkrimeve teknike detale për artikujt që ofertoni”. Sipas kërkesës së lartcekur specifikohet qartë se OE janë të obliguar të sjellin pjesë të katalogut apo prezantime grafike ose fotografi të produkteve për furnizim. Prandaj, kur kemi parasysh këtë kërkesë dhe dokumentet e prezantuara nga ana jonë në ofertë dhe në përgjigjen me sqarime shtesë, kuptohet qartë se ne e plotësojmë në tërësi kërkesën e dosjes së tenderit.

Sa për sqarim, ne në katalog kemi prezantuar produkte të cilat i kemi prodhuar edhe më herët, të njëjta me këto produkte të cilat janë kërkuar edhe në këtë aktivitet të prokurimit. Këtë e kemi dëshmuar me fotografi në katalogun e prezantuar, të cilit i janë bashkëngjitur edhe specifikimet teknike me vizatime teknike të prodhuesit.

Prandaj, në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me arsyetimet të cilat i ka dhënë AK-ja.

Sa i përket mungesës së diagrameve, ku AK-ja tek arsyeja e dytë e eliminimit e ka cekur se mungojnë diagramet e trajtimit termik të cilat duhet të kryhen nga prodhuesi dhe të cilat janë të domosdoshme për verifikimin e cilësisë së produktit, sqarojmë se edhe kjo arsye e eliminimit është e paqëndrueshme. Ne në ofertë kemi dorëzuar deklaratën ku e kemi specifikuar qartë se do t'i përmbahemi në tërësi Aneksit 1, ku janë specifikuar specifikimet teknike nga ana e AK-së. Gjithashtu, në ofertë ne i kemi prezantuar diagramet e trajtimit termik të cilat janë kërkuar nga ana e AK-së dhe të njëjtat janë konform kërkesës së AK-së. Ne nuk e kemi të qartë se si ka ardhur në përfundim AK-ja se kinse ne nuk kemi prezantuar diagramet, përderisa e gjithë oferta jonë është në harmoni të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Duhet sqaruar fakti se në njoftimin mbi vendimin paraprak ne nuk ishim eliminuar për një mungesë të tillë dhe, njëkohësisht, as me sqarime shtesë nuk është përmendur një gjë e tillë për diagramet. Prandaj, tani kjo arsye të cilën e ka dhënë AK-ja për ne është arsye tendencioze, me qëllimin e vetëm të eliminohemi ne si kompani e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Prandaj, arsyetimi i AK-së se kinse na mungojnë dokumentet e tilla është i pabazë dhe i paqëndrueshëm, prandaj kërkojmë që të analizohen në tërësi dokumentet e prezantuara nga ana jonë në ofertë dhe me sqarime shtesë, njëkohësisht kërkojmë që të merret parasysh edhe çmimi me të cilin kemi ofertuar.

Tek arsyeja tjetër e eliminimit, AK-ja e ka cekur se na mungon testi i elasticitetit të materialit të kryer në temperaturë ambienti (+20°C), i cili është evidentuar si kërkesë e detyrueshme për këtë furnizim. Ky arsyetim i AK-së është krejtësisht i paqëndrueshëm, sepse edhe pse në dosjen e tenderit, përkatësisht në FDT, nuk është specifikuar një kërkesë e tillë, ne i kemi prezantuar disa raporte të testimeve. Mirëpo, edhe nëse eventualisht nuk do të kishim prezantuar asnjë raport të testimit, ne në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk do të duhej të ishim eliminuar me një arsye të tillë, për faktin se në dosje të tenderit, përkatësisht tek FDT, e as tek specifikimet teknike nuk është specifikuar një kërkesë e tillë.

Sa për sqarim, kur analizohet Aneksi 1 i dosjes së tenderit, në të njëjtin specifikohet saktë si në vijim. Ndërsa tek përshkrimi gjeneral shënohet si në vijim. Nga faktet e lartcekura vërtetohet qartë fakti se as tek FDT dhe as tek specifikat teknike në Aneksin 1 nuk është kërkuar që të ofrohet testimi për elasticitet. Pikërisht tek specifikat teknike në Aneksin 1 specifikohet dokumentacioni i cili duhet të dorëzohet në fazën e ofertimit, pra as tek këto kërkesa nuk specifikohet që duhet të prezantohet testimi për elasticitet. Testimi për elasticitet vetëm përmendet tek përshkrimi gjeneral, mirëpo nuk është kërkesë decisive për të cilën kërkohet të prezantohet ndonjë dokument si dëshmi.

Prandaj, kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet se autoriteti kontraktues në këtë rast na ka eliminuar për një kërkesë e cila nuk ka qenë e specifikuar në dosje të tenderit, andaj ky veprim i AK-së është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së. Në këtë dispozitë specifikohet qartë: “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Këtë veprim të AK-së ne e shohim si tendencë për eliminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit, pa ndonjë bazë ligjore dhe edhe përkundër faktit që, përveç se i përmbushim të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë.

Sa për sqarim, ne kemi deklaruar tek dokumenti i kapacitetit teknik mbi vendin e shkritores se posedojmë kapacitetin teknik për të kryer analizat e përbërjes së materialeve dhe të gjitha testimet që duhet të kryhen gjatë prodhimit.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, shihet qartë se vendimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm dhe i pambështetur në dispozita ligjore, përkundrazi i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu, edhe një herë, sa për informim, siç jeni njoftuar edhe në dokumentet e prezantuara në ofertë, ju sqarojmë se ne jemi vetë prodhues dhe mund t'i punojmë dhe përgatisim produktet e kërkuara nga ana e AK-së.

Po ashtu, në këtë rast duhet të merret parasysh edhe qëllimi i LPP-së, që është shfrytëzimi më efikas dhe më i drejtë i fondeve publike dhe ruajtja e parasë publike sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-së, pasi që ne kemi ofertuar me çmim më të lirë sesa OE i rekomanduar për kontratë, në vlerën prej 7,962.40 €.

Gjithashtu sqarojmë se ne kemi kërkuar qasje në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë në njoftimin mbi vendimin paraprak, mirëpo AK-ja nuk e ka respektuar nenin 10 dhe 11 të LPP-së, sepse nuk na ka lejuar qasje të plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, duke thënë se është plotësuar Aneksi 3 për sekret afarist.

Me moslejimin e qasjes së plotë nuk është respektuar neni 10 dhe 11 i LPP-së, e po ashtu janë bërë shkelje ligjore të LPP-së, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe janë bërë shkelje edhe të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar Aneksin 3 për sekret afarist, mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka mundur të arsyetojë kërkesën për sekret afarist. Sipas nenit 11 paragrafi 3 të LPP-së, kërkesa duhet të arsyetohet dhe të parashtrohen arsye konkrete, që bindshëm demonstrojnë, sipas

gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të grupit të operatorëve ekonomikë. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë ndonjë dëshmi apo arsye se qasja në dokumente do t'i dëmtonte interesat materiale dhe komerciale të tij, prandaj deklarata e OE të rekomanduar për kontratë nuk mund të merret parasysh, sepse nuk është konform kërkesave ligjore, pasi që shumica e dokumenteve të deklaruara si sekret afarist nuk ndikojnë fare në interesat e kompanisë, duke qenë se të njëjtat janë dokumente të prodhuesit.

Ju sqarojmë se autoriteti kontraktues duhet t'i klasifikojë si sekret afarist informatat dhe dokumentet vetëm nëse janë përmbushur tri kriteret e përmendura në nenin 11.3 të LPP-së. Autoriteti kontraktues është i obliguar t'i respektojë të gjitha dispozitat e LPP-së dhe, në këtë rast, nenin 10 dhe 11 të LPP-së, dhe kur ka një deklaratë për sekret afarist, AK-ja duhet ta analizojë atë dhe, nëse nuk janë përmbushur të tri kushtet e nenit 11.3 të LPP-së, atëherë nuk duhet t'i klasifikojë si sekret afarist dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë.

Pavarësisht që nuk na është lejuar qasje e plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ne, duke e pasur në konkurrencë edhe në tenderë të tjerë OE-në e rekomanduar për kontratë, dyshojmë se ky OE është i papërgjegjshëm, me arsyet si më poshtë.

Ne dyshojmë që i njëjti OE nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, ku është specifikuar: “1. Certifikatë e produktit në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet; 2. Katalogë, pjesë të katalogut apo prezantime grafike (vizatime) ose fotografi të produkteve për furnizim, bashkëngjitur përshkrimeve teknike detale për artikujt që ofertoni”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “1. Certifikatë standardi ISO 9001:2015, të prodhuesit për produktet e ofruara; 2. Dokumentacioni i prodhuesit si katalogë, pjesë të katalogut me përshkrim teknik detajuar për artikujt që ofertoni”.

Dyshojmë që i njëjti OE nuk ka prezantuar certifikatën e produktit sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe, njëkohësisht, produktet me të cilat ka ofertuar i njëjti nuk janë konform kërkesave të specifikimeve teknike të përcaktuara në dosje të tenderit. Prandaj kërkojmë nga ana e AK-së që të verifikohen dyshimet tona dhe të na prezantohen dëshmi konkrete se a e ka përmbushur kërkesën i njëjti OE apo jo.

Ne me datë 09.12.2025 kemi pranuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja ka dhënë arsyetimin se kërkesa është e pabazuar, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete në lidhje me refuzimin e saj.

Autoriteti kontraktues në arsyetimin e tij për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është arsyetuar si në vijim. Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është krejtësisht i paqëndrueshëm dhe, për më tepër, në këtë rast shihet qartë tendenca e të njëjtit për të eliminuar kompaninë tonë nga aktiviteti i prokurimit me çdo kusht.

Ne, në ofertën tonë, në sqarimet të cilat i kemi bërë dhe gjithashtu edhe në kërkesën për rishqyrtim, kemi deklaruar shumë qartë se ne jemi vetë kompani prodhuese, prandaj nuk e kemi të qartë se përse autoriteti kontraktues, në mënyrë të ndryshme dhe me arsyetimet më absurde, po mundohet me çdo kusht të na shpallë si ofertë të papërgjegjshme. Pra, edhe pse ne e kemi sqaruar qartë se ne jemi prodhues të produkteve të kërkuara për këtë aktivitet të prokurimit, autoriteti kontraktues nuk po e merr parasysh këtë fakt, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmimin më të lirë.

Ne kemi dorëzuar katalogun dhe vizatimet sipas kërkesës së dosjes së tenderit, andaj në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk është dashur të eliminohemi me arsyetime të tilla.

Tendencat e autoritetit kontraktues vërtetohen edhe nga fakti se i njëjti në njoftimin mbi vendimin e tij kishte vendosur disa arsye të eliminimit krejtësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, me qëllimin e vetëm që ne të ndalemi dhe të mos parashtrojmë ankesë në OSHP. Tani, i njëjti, në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, nuk i ka përmendur fare ato arsye, mirëpo ka cekur vetëm pikën për vizatimet, të cilat kinse nuk janë të prodhuesit, gjë e cila nuk është e vërtetë.

Sa i përket arsyetimit të AK-së në lidhje me moslejimin e plotë të qasjes në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ku i njëjti ka cekur se është bërë klasifikimi i dokumenteve, sqarojmë se një arsyetim i tillë është i paqëndrueshëm. Ne e kemi cekur qartë se kur autoriteti kontraktues mund t'ia aprovojë kërkesën një OE-je për të deklaruar dokumentet si sekret afarist. Arsyetimi të cilin e ka dhënë OE i rekomanduar për kontratë nuk tregon asnjë arsye faktike dhe të argumentuar se si mund të dëmtohet kompania e tij në rast se lejohet qasja në katalogë. Katalogët dhe certifikatat përbëjnë pjesën kryesore të këtij aktiviteti të prokurimit, prandaj moslejimi i qasjes në këto dokumente shpie drejtpërdrejt në dyshime që i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe i pambështetur në dispozita ligjore konkrete, mirëpo është një arsyetim i cili më shumë favorizon OE-në e rekomanduar për kontratë dhe, njëkohësisht, na diskriminon neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmimin më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lart, rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe, njëkohësisht, nuk është respektuar as kriteri kryesor për dhënien e kontratës, tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Gjithashtu, nuk është respektuar as neni 7 i LPP-së, ku, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur kësaj dispozite ligjore, sepse na ka eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, prandaj ky është diskriminim i hapur.

Po ashtu, autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë as nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me nyje për SRS 470 dhe BRS 1200”, KEKÇ-25-235-111, Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues OE “FONDERIA E & E” SH.P.K. – Gjakovë dhe e refuzon atë me arsyetimin se Komisioni Teknik i Vlerësimit mbetet pranë vendimit të AK-së të marrë më herët.

Edhe pas sqarimeve përmes Letrës Standarde për Sqarim të Tenderit, OE “FONDERIA E & E” SH.P.K. – Gjakovë nuk ka përmbushur të gjitha kriteret dhe kërkesat e AK-së, prandaj oferta e OE “FONDERIA E & E” SH.P.K. – Gjakovë është refuzuar si ofertë e papërgjegjshme.

Sa i përket pretendimit ankimor se OE “FONDERIA E & E” SH.P.K. – Gjakovë ka ofruar katalog me specifikime teknike, ky pretendim nuk qëndron, sepse OE “FONDERIA E & E” SH.P.K. – Gjakovë ka ofruar një broshurë në të cilën janë vendosur vizatime të kombinuara dhe të cilat nuk janë origjinale të prodhuesit.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues se nuk është lejuar qasje e plotë për këtë aktivitet të prokurimit, ky pretendim është i paqëndrueshëm, sepse, konform nenit 11 të LPP-së, me kërkesën me shkrim të OE ankues për sekret afarist, AK-ja i ka siguruar qasje të arsyeshme palës duke përdorur versionin e pastruar, përveç informatave sekrete afariste të kërkuara nga OE i rekomanduar për kontratë në kërkesën e tij për konfidencialitet të dokumenteve dhe të klasifikuara nga AK sipas neneve 68 dhe 69 të LPP-së, që kanë të bëjnë me nenet 8.1 dhe 8.2, si dhe 9.1 dhe 9.2 të FTD-së së DT-së, përkatësisht në pajtueshmëri me nenet 7.1, 7.3, 7.5, 7.6 dhe 7.7 të RRUOPP-së.

Në kontekst të kësaj, konfirmojmë se, përkundër kërkesës së OE ARB-COM SH.P.K. që e tërë oferta e tij të jetë konfidenciale, AK-ja nuk e ka klasifikuar si sekret afarist të gjithë dokumentacionin, por ka klasifikuar vetëm dokumentacionin sipas neneve 68 dhe 69 të LPP-së. Në kuadër të kësaj, OE ankues i është dhënë qasja në tërë ofertën, përveç siç është shpjeguar më lart (dokumenti i bashkëngjitur kësaj kërkesë për rishqyrtim).

AK-ja deklaron se aktiviteti i prokurimit është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, dhe ka shpërblyer me kontratë OE të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1243, ndërsa me datë 09.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1243, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues,

shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEFONDERIA E & E SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1243 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMEVE ANKIMORE TË OE " AROMA PLUS " SH.P.K."- Prishtinë

Pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik ankues dhe dokumentacionit përkatës të procedurës së prokurimit, konstatohet se pretendimet ankimore janë paraqitur në mënyrë të përgjithësuar dhe pa ndarje të qartë të pretendimeve ankimore sipas çështjeve konkrete të kontestuar.

Për qëllim të analizës së qartë, objektive dhe profesionale, eksperti i prokurimit e ka parë të nevojshme që pretendimet e parashtruara nga OE të strukturohen dhe të ndahen në pretendime të veçanta, në përputhje me natyrën e shkeljeve të pretenduara nga ana e OE ankues,

Kjo ndarje e pretendimeve nuk përbën ndryshim të përmbajtjes së ankesës, por është bërë vetëm me qëllim të sistemit dhe lehtësimit të trajtimit analitik të se cilit pretendim veç e veç, në mënyrë që të mundësohet dhënia e një përgjigjeje të saktë, të arsyetuar dhe të bazuar në legjislacionin në fuqi.

PRETENDIMI 1- Eliminimi I pa bazuar - arsyeve të reja të eliminimit pas rivlerësimit

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se Autoriteti Kontraktues, pas aprovimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK ndaj Vendimit B58 -I- dhe kthimit të lëndës në fazën e rivlerësimit, gjatë këtij procesi AK ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me katalogjet e ofruara, ndërkohë që në të njëjtën kohë ka shtuar arsye të reja për eliminim me Vendimit B58 -II-. Sipas pretendimit të OE ankues, këto arsye të reja nuk kanë qenë të përfshira në njoftimin mbi vendimin paraprak dhe as nuk kanë qenë objekt i kërkesës për sqarime shtesë,

OE ankues vijon pretendimet e tij duke theksuar, ndër të tjera, se është eliminuar nga Autoriteti Kontraktues me arsyetimin se ka dorëzuar një broshurë të kombinuar që përmban vetëm disa fotografi, pa specifikime teknike dhe pa dokumentacion zyrtar të prodhuesit, OE ankues sqaron se ky arsyetim është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar, duke pretenduar se vetë është prodhues i mallrave objekt prokurimi dhe për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur prej tij përmbush kërkesat e përcaktuara nga AK-së.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 1-

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues me Vendimin e AK B58 -I- ka eliminuar OE ankues me arsyetimin se:

Në dosjen e tenderit është kërkuar: 2. Dokumentacioni i prodhuesit si katalogë pjesë të katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt që ofertoni, ndërsa ju keni ofruar katalog pjesë të katalogut me përshkrime teknik për artikujt që ofertoni të kërkuara në dosje të tenderit ju keni ofruar disa vizatime teknike dhe brochure të cilat nuk i përkasin këtij aktivitetit të prokurimit.

Pas kesaj AK ka pranuar Kërkesë për rishqyrtim nga ana OE " FONDERIA E & E SH.P.K."- të cilën e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar duke kthyer lëndën në rivlerësim, gjatë fazës së

rivlerësimit, i ka kërkuar Operatorit Ekonomik sqarime shtesë me datë 21.11.2025 si vijon:

OE ankues i është përgjigjur kërkesës për sqarim duke ofruar domumentacionet e kërkuara nga ana e AK.

Autoriteti kontraktues nxjerr vendimin e Ak-se për herë të dyte duke e eliminuar OE ankues për keto arsye përmes letres standarde të dates 03.12.2025 me arsyet tjera të refuzimit të tenderit gjatë fazës së rivlerësimit nga ana e autoritetit kontraktues:

Tendëri juaj është refuzuar për këto arsye:

Materiali i dorëzuar nuk përmban specifikime teknike të kërkuara. Juve ju është kërkuar të ofroni katalog të prodhuesit me specifikime teknike të detajuara për artikujt e ofruar.

Në vend të kësaj, ju keni dorëzuar një broshurë të kombinuar vetëm me disa fotografi, pa specifikime teknike dhe pa dokumentacion zyrtar të prodhuesit.

Përkundër përgjigjes sqaruese nga AK, ju nuk keni arritur të dëshmoni përmbushjen e kërkesave teknike.

Mungojnë diagramet e trajtimit termik.

Në dokumentet e ofertës mungojnë diagramet e trajtimit termik që duhet të kthehen nga prodhuesi, të cilat janë të domosdoshme për verifikimin e cilësisë së produktit.

Mungon testi i elasticitetit (+20°C).

Nuk është ofruar testi i elasticitetit të materialit të kryer në temperaturë ambienti (+20°C), i cili është i vendosur si kërkesë e detyrueshme për këtë furnizim.

Ekskpeti shqyrtues sqaron se OE FONDERIA E & E SH.P.K.”- Prishtinë i pa kenaqur me vendimin nga ana e Autoritetit kontraktues ka bërë kërkesë për rishqyrtim ku AK -Kërkesën për rishqyrtim ka refuzuar si të pabazuar si vijon:

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin si me lartë sqaron se Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në dosjen e tenderit nga ana e AK-së ishin:

Nga kjo kërkesë rezulton qartë se paraqitja e katalogut, prezantimeve grafike ose fotografive cilën do nga keto së bashku me përshkrime teknike është e mjaftueshme për përmbushjen e kriterit.

Dokumentacioni i dorëzuar nga OE, si në ofertë ashtu edhe në sqarimet shtesë, plotëson këtë kërkesë.

Arsyetimi i AK-së se Operatori ekonomik ka dorëzuar vetëm një broshurë me fotografi, pa specifikime teknike dhe pa dokumentacion zyrtar të prodhuesit, është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar mbi kërkesat në dosjen e tenderit e tenderit nga se OE ka nënshkruar deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të detyrueshme -ANEKSI 1.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të deshmive ka verejtur se OE anues ka sqaruar qartë, si në kërkesën për rishqyrtim ashtu edhe në përgjigjen ndaj sqarimeve shtesë si dhe me deklaratën e dorëzuar me ofertë se është vetë prodhues, prandaj nuk mund të kërkohej dokumentacion nga një

prodhues i dytë me qenese OE ankues është vet prodhues dhe OE ankues ka ofruar katalogsi vijon:

Si rrjedhoje ky pretendim është I bazuar.

PRETENDIMI 2 –Pretendim- mungesë të diagrameve të trajtimit termik

Pretendimi I OE ankues se AK na ka elmeninuar me arsyetimin se nuk kemi dorëzuar diagramet e trajtimit termik të cilat duhet të kryhen nga prodhuesi është i paqëndrueshëm,duke sqaruar se në kemi dorëzuar deklaratë për përmbushje të Aneksit 1 dhe kemi prezantuar diagramet e kërkuara, të cilat janë konform specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK dhe se oferta jonë është në harmoni të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke kërkuar që të merret parasysh edhe çmimi me të cilin kemi ofertuar dhe që është çmimi me i lirë.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 2-

Eksperti shqyrtues sqaron se nder të tjera në kuader të dosjes se tenderit Aneksi 1 –specifikat teknike ishin:

Ofertuesi me oferte duhet të dorëzoje dokumentacionin:

- Afatin e liferimit 120 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës
- OE të deklaron prodhuesin me të cilin konkurren dhe vendin e origjinës se prodhuesit.
- Katalogët e prodhuesit dhe vizatimet e prodhuesit
- Referencat e shitjes se prodhuesit me derdhje të natyrës së ngjashme
- ISO certifikatën e kualitetit
- Deklarata e CE e konformitetit
- Garancioni 12 muaj
- Të jepen diagramet e trajtimit termik të cilat do të kryhen nga prodhuesi

Eksperti shqyrtues bazuar në këtë sqaron OE “ FONDERIA E & E SH.P.K.”- ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në fazën e ofertimit dhe përgjigje ndaj kërkesës për sqarim përfshirë:

Deklaraten nën betim;

Ka nënshkruar Aneksin 1-specifikat teknike të detyrueshme të dosjes se tenderit fletë për fletë për secilin pozicion;

OE ankues ka nënshkruar deklaratë mbi përmushjen e specifikimeve teknike të detyrueshme duke u zotuar se do ti përmbahet Aneksit 1 sipas DT;

Deklaraten e CE e Konformitetit përmes se cilës Operatori Ekonomik, në këtë rast „Fonderia E & E“Sh.p.k deklaron se të gjitha prodhimet do të bëhen duke I përmbushur standartet e CE-së;

Deklaratë - Mbi origjinën e mallrave me të cilën deklaron se prodhimi i dhëmbëve për lugë të eskavatorëve sipas kësaj dasje të tenderit do të bëhet në ndërmanjen tonë: "Fonderia E&E "Sh.p.k. në Gjakovë. Si prodhues në garantojmë se prodhimet do të liferohen sipas kërkesave teknike të kërkuara në dosjen Tuaj, dhe në bazë të vizatimit dhe kërkesave teknike të kërkuara nga ana juaj;

Deklaratë për garanci të prodhuesit për cilësinë e produkteve përmes se cilës FONDERIA E&E SH.P.K. frojnë siguri të plotë dhe garantojnë që produktet tona të ofruara për tenderin i Prokurimit Publik nr: KEK-25-7550-1-1-1 dhe Nr i Brendshëm: KEKC-25-235-111 Furnizim me nyje per SRS 470 dhe BRS 1200 do të furnizohet si i ri dhe i cilësisë më të mirë sipas standardeve ISO për çelieqet e derdhur, pa defekte nëmaterial,plasaritje,kontrolluar pa deformim, cilësi e kontrolluar etj.Në procesin e prodhimit do të aplikohen kodet teknike të ISO dhe versionet më të fundit në publikimet përkatëse të IEC. Gjithashtu, do të aplikohet edhe sistemi metrik i njësive inxhinierike (SI) dhe testi I elasticitetit. FONDERIA E&E SH.P. K është e pajisur me certifikata për cilësinë e prodhimit për shkritoren, do të prodhojë materialin i cili është pjesë e standardeve më të fundit;

OE ka dorezuar -Diagramin e trajtimit tërmik

Deklaratë garancioni dhe liferimi sipas kërkesës së Autoritetit kontraktues – afatin e liferimit 120 ditë;

Përshkrimi i pajisjeve teknike dhe kapacitetit;

Katalogun;

Referenca të ngjashme;

OE ka deklaruar se Materialet do të jenë pjesë e standardeve të fundit prodhuar nga ne, e që jemi të pajisur me certifikata mbi kualitetin e prodhimit.

Certifikatën ISO sipas kërkesës.

· Vlen të përmendet se tek specifikat teknike Ankesi 1 ka qene e cekur nga na e AK se se Çdo OE mund të ofertoj me prodhime ekuivalente. Operatori ekonomik qe konkurron është i obliguar të dëshmoj me dokumentacion se produktet e ofertuar janë të barasvleshme dhe ekuivalente me kërkesat të vendosura në specifikimin teknik në dosje të tenderit.

Bazuar në këtë pretendimi ankimor se Arsytimi i AK-së se OE nuk ka dorëzuar diagramet e trajtimit tërmik është i paqëndrueshëm, pasi që OE ka dorëzuar gjithë dokumentacinin me oferte si me lartë po ashtu gjatë fazës së rivlerësimit permes sqarimit OE ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara nga AK-ja, përfshirë katalogun me fotografi të produkteve të prodhuara më herët, të cilat janë të njëjta me produktet e kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit, si dhe specifikime teknike dhe vizatime të prodhuesit.

Nga sqarimi si me lartë pretendimi ankimor është I bazuar.

PRETENDIMI 3-eliminim jasht kerkeses në dosje për testin e elasticitetit të materialit (+20°C)

Pretendimi i radhës nga OE ankues se AK na ka eliminuar duke u thirrur në mungesën e testit të elasticitetit të materialit në temperaturë ambienti (+20°C), i cili është evidentuar si kërkesë e

detyrueshme për këtë furnizim, edhe pse një kërkesë e tillë nuk është specifikuar as në FDT të cilat vërtetojnë qartë fakti se as tek FDT as në Aneksin 1 dhe as në specifikimet teknike të dosjes së tenderit, nuk ka qene kerkese që të ofrohet testimi për elasticitet tuje OE anukes tutje sqaron se në i kemi prezantuar disa raporte të testimeve edhe pse nuk specifikohet që duhet të prezantohet testimi për elasticitet vetëm përmendet tëk përshkrimi gjeneral, mirëpo nuk është kërkesë decideve për të cilën kërkohet të prezantohet ndonjë dokument si dëshmi andaj ky veprim i AK-së është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-

.PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 3

Eksperti shqyrtues sqaron se tek Aneksi 1 në dosje të tenderit ka qene pjesa e Informacione shitesë si vijon:

-Testi elasticitetit kryer në temperaturën e dhomës (+ 20°C)

Bazuar në kete eksperti shqyrtues sqaron se nuk është specifikuar një kërkesë e tillë sa I perket testi elasticitetit por vetem si informacion shtese dhe jo kriter në dosjen e tenderit dhe Njoftimit per kontrate po ashtu vlen të përmendet se OE ka prezantuar disa raporte të testimeve gje qe nuk përben bazë për eliminim po ashtu OE ka nënshkruar Deklaratën nën betim se do të përmbush specivikat teknike sipas Aneksit 1. Prandaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura Autoriteti Kontraktues nuk mund te elemolinoj nje OE nga procedura e prokurimit duke u bazuar ne nje një kërkesë e cila nuk ka qenë e specifikuar tek kriteret në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë pasi që kjo bie në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së.:

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Po ashtu Rregulloren në fuqi neni 40.12 dhe 40.13 si vijoje

40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

40.13 Komisioni vlerësues do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Pretendimi ankimor është i bazuar.

PRETENDIMI 4 - Mohim i qasjes në dokumente dhe dyshime mbi përgjegjshmërinë e OE të rekomanduar

Pretendimi i radhës i OE ankues është se Autoriteti Kontraktues nuk i ka lejuar qasje të plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, duke u thirrur se OE ka plotësuar (Aneksi 3) sekretit afarist pa bërë vlerësimin dhe arsyetimin e kërkuar sipas nenit 11 paragrafi 3 të LPP-së. Sipas OE ankues, ky veprim përbën shkelje të neneve 10 dhe 11 të LPP-së, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke pamundësuar verifikimin e përgjegjshmërisë së OE të rekomanduar për kontratë.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 4

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në shqyrtimi e fakteve rezulton se kërkesa për qasje është bërë nga ana e OE ankus, ZPP-ja ka lejuar qasjen e kufizuar OE.

Eksperti shqyrtues lidhur me Pretendimi se qasja është kufizuar dhe AK ka vepruar në harmoni me nenet LPP dhe Rregullores në fuqi si vijon:

Neni paragrafi 3 i nenit 10 të LPP-së :

3. Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

Neni 7 paragrafi 7.2, 7.4 , 7.6.3 Rregullore për prokurimin publik (Versioni i Konsoliduar)

Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion, Rregullore për prokurimin publik

7.2 Qasja në të dhënat e aktivitetit të prokurimit fillon në datën e pranimit nga OE të njoftimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit – publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK.

7.4 Përveç dokumenteve të klasifikuara si informata sekrete afariste, AK do ti ofroj, çdo pale të interesuar që bënë kërkesë, qasje të shpejtë dhe të arsyeshme në të gjitha të dhënat për aktivitetin e prokurimit. Pala e interesuar në fjalë do të ketë qasje në dokumente duke konsultuar ato në zyrën e prokurimit. Konsultimi në zyrën e prokurimit, nëse bëhet fjalë për më pak se 20 faqe A4 dhe qasje direkte të formës elektronike do të jenë të lira nga tarifa

7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues ka lejuar qasjen duke u bazuar në nenet e lartëcekura dhe se operatori ekonomik N.T.SH. " ARB - COM "- ka nënshkruar kërkesën për sekret afarist dhe deklaratën mbi klasifikimin e dokumenteve si sekret afarist.

Bazuar si me lartë pretendimi ankimor nuk është i bazuar.

PRETENDIMI 5 - shkelje e nenit 1, 7, 59 të LPP-së

OE ankues në pretendimin e tij rreth shkeljes nenin 59 të LPP-së pretendon se nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët, neni 7 i LPP-së dhe neni 1-Qellimi i LPP-së ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 5

Eksperti shqyrtues sqaron nenin 1 të LPP-së, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe në mënyrë të drejtë shfrytëzimin e fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së ka për qëllim që të udhezoi Autoriteti kontraktues se si do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, neni 59 I LPP-së ka për qëllim të udhezoi Autoritet kontraktues se si të bëjnë Vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tendereve duke mos diskriminuar apo favorizuar asnjë Operator ekonomik. Gjithëashtu bazuar në kriterin e dhenjës –tenderi I përgjegjshëm me çmim më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit OE FONDERIA E & E SH.P.K.”- Prishtinë kishte ofertuar më çmim më të ulët në këtë aktivitet të prokurimit.

Bazuar në këtë dhe në pretendimet e lartë cekura pretendimi ankimor është bazuar.

PRETENDIMI 6- Dyshime rreth mos përbushjes së kriterëve nga OE i rekomanduar

OE ankues ka ngritur dyshime se OE I rekomanduar për kontrate nuk ka prezantuar certifikatën e produktit sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe njëkohësisht produktet me të cilat ka ofertuar i njëjti nuk janë konform kërkesës së specifikimeve teknike.

PERGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT 6

Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin 6 sqaron OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatën ISO 9001:2015 me afat të skaduar sipas Vertetimit përmes QR code data e vlefshmerise është 29.01.2025. Po ashtu, specifikimet teknike janë paraqitur në gjuhën angleze.

Gjithashtu, në deklaratën e OE-së së rekomanduar për kontratë lidhur me origjinën e mallrave, është cekur se mallrat do të furnizohen nga Turqia, mirëpo nuk është specifikuar prodhuesi i tyre.

Si I tille ky pretendim ankimor është I bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me nyje për SRS 470 dhe BRS 1200 me numër të prokurimit KEK-25-7550-1-1-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje Paneli Shqyrtues ja fal besimin ekspertit shqyrtues profesional dhe ekspertit teknik, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli konsideron se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për

dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - " FONDERIA E & E " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: